



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 544 Prot.

Tiranë, më 18 . 2 .2025

URDHËR

Nr. 25 , Datë 18 . 2 .2025

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2025 NË  
INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Në zbatim të nenit 18, pika 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”, vendimit nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si dhe vendimit të Presidentit të Republikës, nr. 4, datë 13.2.2024, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit”, pasi shqyrtova ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil pranë Institucionit të Presidentit të Republikës,

URDHËROJ:

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim në shërbimin civil në administratën e Institucionit të Presidentit të Republikës për vitin 2025 do të jetë, sipas tabelës më poshtë:

Pozicioni	Nr. vende vakante	Kategoria	Klasa e pagës
Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike	1	Niveli i lartë drejtues	I-4
Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, Menaxhimit Financiar dhe Shërbimeve	1	Niveli i lartë drejtues	I-4
Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë, Diasporën dhe Shërbimeve Ceremoniale	1	Niveli i mesëm drejtues	II-1

Drejtor i Drejtorisë së Medias dhe Marrëdhënieve me Publikun	1	Niveli i mesëm drejtues	II-1
Specialist në Sektorin e Çështjeve Ligjore dhe Faljeve	1	Kategoria ekzekutive	IV-1
Specialist në Sektorin e Shtetësive	1	Kategoria ekzekutive	IV-1
Specialist në Sektorin e Dekorimeve dhe Titujve e Nderit	1	Kategoria ekzekutive	IV-1
Specialist për Kibernetikën	1	Kategoria ekzekutive	IV-1
Specialist për Median	1	Kategoria ekzekutive	IV-1
Specialist në Sektorin e Komunikimit Digjital	2	Kategoria ekzekutive	IV-1

2. Ngarkohet Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimit Financiar, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

*Valbona Lusha*  
**Valbona Lusha**

